UDHËZIM
Nr. 11, datë 26.6.2023

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 5.7.2022 "PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 48, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 17, datë 5.7.2022, "Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar", i ndryshuar, pas nenit 9/2, të shtohet neni 9/3 me përmbajtje, si më poshtë:

Neni 9/3
"Vlerësimi i nxënësve në institucionet e arsimit special"

1. Në institucionet e arsimit special të nxënësve që nuk dëgjojnë, vlerësimi në klasat 1–9 për të gjitha lëndët mësimore dhe modulet profesionale bëhet sipas këtij udhëzimi, me përjashtim të lëndëve speciale për klasat 1–3, për të cilat vlerësimi bëhet për lëndë dhe në kolonën e kompetencave vendoset vetëm emërtimi i lëndës. Në institucionet e arsimit special për nxënësit që nuk dëgjojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe në lëndën e gjuhës angleze, në klasat 1–3 hiqet kompetenca e të dëgjuarit.

2. Në institucionet e arsimit special të nxënësve që nuk shikojnë, vlerësimi në klasat 1–9 për të gjitha lëndët mësimore bëhet sipas këtij udhëzimi, me përjashtim të lëndëve speciale për klasat 1–3, për të cilat vlerësimi bëhet për lëndë dhe në kolonën e kompetencave vendoset vetëm emërtimi i lëndës.

3. Në institucionet e tjera të arsimit special, përveç atyre të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, vlerësimi bëhet si më poshtë:

a) në përfundim të çdo periudhe, në çdo lëndë mësimore, nxënësit vlerësohen me fjalë dhe shprehje në klasat 1–3 dhe me një notë në klasat 4–9. Ky vlerësim është rezultat i të gjitha vlerësimeve/notave që nxënësi ka marrë gjatë periudhës në lëndën përkatëse;

b) numri i notave në çdo lëndë mësimore për një periudhë është sipas këtij udhëzimi;

c) vlerësimi përfundimtar vjetor (nota vjetore) në çdo lëndë mësimore është rezultat i tri vlerësimeve/notave të periudhave;

d) për përcaktimin e vlerësimit të periudhave dhe vlerësimit përfundimtar mësuesi duhet të marrë në konsideratë progresin e nxënësve;

e) dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit për lëndët mësimore është si në tabelën më poshtë:

Periudha e parë	Periudha e dytë	Periudha e tretë	Vlerësimi përfundimtar
- Vlerësim me fjalë e shprehje në klasat 1–3. *- Vlerësim me notë në klasat 4–9.*	*- Vlerësim me fjalë e shprehje në klasat 1–3.* *- Vlerësim me notë në klasat 4–9.*	*- Vlerësim me fjalë e shprehje në klasat 1–3.* *- Vlerësim me notë në klasat 4–9.*	*- Vlerësim me fjalë e shprehje në klasat 1–3.* *- Vlerësim me notë në klasat 4–9.*

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi